



This project is funded
by the European Union



ISD

Powering new
generations
against extremism



Terre des hommes
Helping children worldwide. tdh.ch



**MODULI I TRAJNIMIT TË MESUESVE NË LIDHJE ME
RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM**

1
“Moduli i Trajnimit është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ”.

MODULI I TRAJNIMIT TË MESUESVE NË LIDHJE ME RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM

1. Lloji i trajnimit

Trajnim i drejtpërdrejt (Neni 5/1 i Udhëzimit)	“V”
Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime (Neni 5/2)	
Trajnimi nëpërmjet internetit (Neni 5/3)	

2. **Titulli i programit të trajnimit:** Zhvillimi profesional i mësuesve dhe zhvillimi i shkollës

3. **Tema e modulit:** Radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm

4. Numri i orëve të modulit të trajnimit: 18 orë (12 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 6 orë workshope me secilin target grup për të koordinuar në zbatimin e qasjes në shkollën qendër komunitare në terren).

5. **Numri i seancave dhe tema e çdo seance.**

Seancat	Tema	Kohëzgjatja
Seanca 1	I. Përkufizimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm II. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar	3 orë
Seanca 2	IV. Roli i Medias dhe Teknologjisë V. Roli i familjes dhe komunitetit VI. Roli i institucioneve dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre	3 orë
Seanca 3	Faktorët socialë	
Seanca 4	VII. Roli i arsimit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm VIII. Shfaqjet lokale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm	3 orë
Seanca 5	IX. Menaxhimi i diskutimit në klasë	3 orë

2

“Moduli i Trajnimit është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ”.

	X. Temat për adresimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm XI. Mesazhet kryesore që duhet të transmetohen	
Seanca 6	Realizimi i aktiviteteve në shkollë dhe detyra praktike	6 orë
Totali		18 orë

6. Përfituesit nga trajnimi.

Përfituesit e mundshëm nga trajnimi janë:

- *mësues* të lëndëve në Arsimin e mesëm të Lartë
- *drejtues të* shkollave të Arsimin të mesëm të Lartë;
- *mësuesit e TIK-ut;*
- *koordinatorët e Shkollës Qendër Komunitare*

7. Rezultatet e pritshme.

- ✓ Kanë arritur një kuptim të përbashkët të njëjtë mbi qasjen “e zhvillimit të aktiviteteve për të minimizuar radikalizmin e dhunshëm”.
- ✓ Dallojnë llojet e veprimtarive që kryen shkolla si Qendër Komunitare, për të forcuar komunitetin, nxënësit kundër radikalizmit të dhunshëm.
- ✓ Kanë zhvilluar aftësitë e duhura për të planifikuar në nivel institucioni në afate kohore vjetor dhe tremujor veprimtaritë në kuadrin e nismës.
- ✓ Kanë zhvilluar aftësitë për zgjidhjen e konfliktit në shkollë.
- ✓ Kanë zhvilluar kompetenca për ti mbrojtur nxënësit nga rrjetet sociale dhe informacionet e dëmshme digjitale.

8. Përshkrimi i përmbajtjes.

“Radikalizimi” dhe “ekstremizmi i dhunshëm” janë ndër sfidat më të përhapura të kohës sonë. Ndërsa “ekstremizmi i dhunshëm” nuk kufizohet nga mosha, gjinia, grupi apo komuniteti, të rinjtë janë veçanërisht të prekshëm ndaj mesazheve të ekstremistëve të dhunshëm dhe organizatave terroriste.

Shqipëria konsiderohet tradicionalisht një vend tolerant, me dialog konstruktiv ndër fetar dhe një radikalizim të kufizuar. Megjithatë, radikalizimi është një kërcënim global dhe në vitet e fundit,

3

“Moduli i Trajnimit është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ”.

Shqipëria ka qenë gjithashtu e prekur, së bashku me disa shtete anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit perëndimor, nga fenomeni i luftëtarëve të huaj.

Që nga viti 2013, rreth 120 shtetas shqiptarë, disa prej tyre, së bashku me anëtarët e familjes, janë larguar nga vendi për t'u bashkuar me zonat e luftës në Lindjen e Mesme. 30-40 luftëtarë të huaj janë kthyer në Shqipëri dhe jetojnë në kushte të përjashtimit apo vetë-përjashtimit social.

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian 2015 ka njohur përpjekjet e Shqipërisë për të trajtuar radikalizimin dhe terrorizmin dhe i ka bërë thirrje Shqipërisë të "zhvillojë një politikë efektive për të parandaluar radikalizmin, duke përfshirë masat për zbatimin e ligjit dhe veprimeve socio-ekonomike që kanë për qëllim forcimin e përfshirjes sociale, veçanërisht në mesin e të rinjve, si dhe për të rritur përpjekjet për të identifikuar dhe parandaluar dhe rrjedhën e luftëtarëve të huaj që udhëtojnë në zonat e konfliktit si Irak dhe Siri".

Përballë kërcënimeve të tilla, të rinjtë kanë nevojë për mundësi për mësim në kohë për të zhvilluar njohuritë, aftësitë, dhe qëndrimet që mund t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë qëndrueshmërinë e tyre ndaj një propagande të tillë. Këto kompetenca mund të zhvillohen me ndihmën e mësuesve të përgatitur mirë dhe të respektuar, të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me të rinjtë. Duke u nisur nga ky fakt, ky modul trajnimi u hartua për mësuesit në arsimin parauniversitar (të ulët dhe të mesëm), me bindjen se mund të mbështesë përpjekjet e mësuesve që punojnë në mjediset arsimore. Më konkretisht, ky modul trajnimi synon që:

- ❖ Të japë një informacion në lidhje me konceptin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, kuadrin ligjor ekzistues, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe faktorët socialë;
- ❖ Roli i arsimit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- ❖ Dhënien e këshillave praktike se kur dhe si mësuesit të diskutojnë mbi çështjen e ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm me nxënësit;
- ❖ Orientimin e mësuesve të krijojnë një klimë në klasë që është gjithëpërfshirëse dhe e favorizon dialogun e respektueshëm, diskutimin e hapur dhe të menduarit kritik.

I. Përkufizimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Ekstremizmi i dhunshëm i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunë të motivuar ideologjike për të arritur pikëpamjet radikale ideologjike, fetare

apo politike. Pikëpamjet ekstremiste të dhunshme mund të ekspozohen përgjatë një sërë çështjesh, duke përfshirë politikën, fenë dhe marrëdhëniet gjinore. Asnjë shoqëri, bashkësi fetare apo botëkuptim nuk është imun ndaj ekstremizmit të tillë të dhunshëm.

Ekstremizmi i dhunshëm është: *"kur nuk lejoni një pikëpamje tjetër; kur i mbani pikëpamjet tuaja si mjaft ekskluzive, kur nuk lejoni mundësinë e ndryshimit dhe kur doni ta impononi këtë pikëpamje ndaj të tjerëve, duke përdorur edhe dhunën nëse është e nevojshme"*.

Megjithëse *"radikalizmi"* është një term i kontestuar për disa, ai është përdorur për të përcaktuar procesin përmes të cilit një individ ose një grup individësh e konsideron dhunën si një mjet legjitim të veprimit. Mendimi radikal që nuk pranon ushtrimin e dhunës për qëllime të mëtejshme politike, mund të shihet si normal dhe i pranueshëm, dhe promovohet nga grupime që veprojnë brenda kufijve të ligjit.

Paraprakisht, duhet theksuar se nuk ka definicion konsensual dhe të qartë në lidhje me termin *"radikalizim"*, që mund të gjendet në instrumentet ekzistuese ligjore ndërkombëtare pavarësisht nga numri i madh i instrumenteve të tilla që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe pavarësisht rezolutave e ndryshme dhe literaturës së gjerë mbi këtë temë.

Ekziston një konsensus, e parë në këndvështrimin ligjor dhe një farë mase dhe në atë psikologjik, që *"radikalizmi"* është një fenomen më abstrakt dhe më i gjerë sesa konceptet që lidhen me *"terrorizmin"* dhe *"ekstremizmin e dhunshëm"*.

Radikalizimi përshkruhet si një proces që ka shumë të ngjarë të çojë në akte të kualifikuara shpesh si terrorizëm ose ekstremizëm, por jo domosdoshmërisht (aktet e dhunshme që mund të rezultojnë nga radikalizimi mundet në disa raste të cilësohet si *"kryengritje"*, *"rebelim"*, *"luftë civile"* apo edhe *"luftë"*).

Në kundërshtim me *"radikalizmin"*, *"terrorizmi"* është direkt ose indirekt i përcaktuar në disa rezoluta dhe traktate.

Këshilli i Bashkimit Evropian e përkufizon *"terrorizmin"* si: *"akte të qëllimshme që janë kryer me qëllim të frikësimit, në mënyrë serioze, të një popullsie, ose duke imponuar në mënyrë të padrejtë një qeveri apo organizatë ndërkombëtare për të kryer ose për tu përmbajtur nga kryerja e ndonjë veprimi, apo të destabilizojë/shkatërrojë në mënyrë serioze strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të një vendi ose një organizate ndërkombëtare"*.

Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk ka asnjë përkufizim të rënë dakord ndërkombëtarisht në lidhje me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm ose radikalizmin. Një nga arsyt duket të jetë vështirësia në përshtatjen e shqetësimeve të ngritura nga *Organizata e Konferencës Islamike*, e cila shprehimisht përjashton luftën e armatosur për çlirim nga pushtimi dhe luftën për vetëvendosje.

Në nivel evropian, përkufizimi i termit "radikalizëm" nuk ka qenë i mundur të shfaqet deri në përmendjen e këtij termi nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe ky përdorim shprehet në një kontekst të ndryshëm.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, e datës 16 maj 2005, nuk e përcakton termin "*radikalizëm*" por përmban përkufizimin për "*provokim publik për kryerjen e veprës terroriste*" në nenin 5, si: "*shpërndarja, ose vënia në dispozicion, të një mesazhi për publikun, me qëllim për të nxitur kryerjen e një vepre terroriste, ku një sjellje e tillë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo përkrah veprat terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla mund të kryhen*".

Konventa përcakton gjithashtu "*rekrutimin për terrorizëm*" (Neni 6), si: "*akt për ti kërkuar një personi tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, ose për t'u bashkuar me një grup, me qëllim për të kontribuar në kryerjen e një apo më shumë veprave penale terroriste nga ana e këtij grupi*".

Shumica e përkufizimeve të përdorura aktualisht, e përshkruajnë "radikalizmin" si "*proçes ku individë ose grupe individësh miratojnë dhe, në fund të fundit, marrin pjesë në përdorimin e dhunës për qëllime ideologjike, politike apo fetare*". Disa autorë i referohen "*radikalizmit të dhunshëm*", për të theksuar rezultatin e dhunshëm dhe dallimin e proçesit nga forma jo të dhunshme "radikale" të të menduarit.

Të gjithë terroristët janë radikal dhe jo të gjithë radikalët janë terroristë për faktin se jo të gjitha format e radikalizmit dhe ekstremizmit evoluojnë në dhunë dhe terror. Radikalizmi nuk përbën kërcënim për një shoqëri, në rast se nuk lidhet me dhunën apo veprime të tjera të paligjshme, të tilla si: nxitja e urrejtjes, sipas përshkrimit në jurisprudencën që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Radikalizmi mund të rezultojë si një forcë pozitive ndryshimi.

Sa për ilustrim, individët që luftuan për heqjen e skllavërisë apo ata që kërkuan të drejtën universale të votës, për kohën në të cilën jetuan, u konsideruan si radikalistë, duke qenë se ishin kundër ideve mbizotëruese në shoqëritë e tyre. Radikalizmi terrorist është një proces dinamik, sipas të cilit individit nis ta pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit.

Nuk ka asnjë profil të vetëm, i cili do të përfshinte të gjithë radikalistët apo ekstremistët e dhunshëm, sikundër nuk ekziston asnjë rrugë “e prerë me thikë“, e cila i çon individë të tillë në rrugën drejt terrorizmit. Shtysat e mundshme të radikalizmit terrorist janë të ndryshme dhe komplekse, duke u ndërthurur në mënyrë unike, për çdo rast specifik. Profilet që ndërtohen mbi bazën e supozimeve të stereotipizuara, mbi bazën e përkatësisë fetare, racore, etnike, gjinore, statusit shoqëror dhe ekonomik etj, jo vetëm që janë diskriminuese por po ashtu janë edhe të paefektshme.

Është plotësisht llogjike që të hidhet poshtë me vendosmëri, identifikimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm apo dhe i terrorizmit me kombësinë, përkatësinë fetare apo etnike. Përballja me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm kërkon një reagim të sofistikuar dhe gjithëpërfshirës.

Kjo duhet të përfshijë veprime efikase të drejtësisë penale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe sundimit të shtetit të së drejtës kundër atyre që nxisin të tjerët për akte të dhunshme, si edhe përpjekje shumëplanëshe për trajtimin e kushteve që favorizojnë radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

9. Metodologjia.

a) Metodot gjatë trajnimit

Metodologjia që do të përdoret në këtë modul: **Trajnim i drejtpërdrejt** nëpërmjet **diskutimit** dhe **debatit**.

Puna në grup

- **Faza I** (15 min): Shfaqja me Power- Point e rubrikave që do të përmbajë trajnimi.

Faza II (30 minuta): Pjesëmarrësit nëpërmjet pemës së mendimeve shkruajnë në fleta të vogla dhe i ngjisin në fleta flipcharteri pritshmëritë e tyre rreth këtij moduli.

7

“Moduli i Trajnimit është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ”.

1. Sugjerohet që trajnuesi/ja të mbajë shënim pritshmëritë e pjesëmarrësve në një fletë *flipchart* në mënyrë që të mund të përshtatë programin me nevojat e dëshirat e tyre.
2. Ky ushtrim shërben edhe për të matur dobishmërinë e trajnimit, duke krahasuar pritshmëritë me vlerësimin përfundimtar të pjesëmarrësve.
3. Sugjerohet që trajnuesi/ja t'i pyesë pjesëmarrësit, nëse kanë marrë pjesë më parë në trajnime/seminare apo të tjera aktivitete informuese të ngjashme, në mënyrë që të masë paraprakisht njohuritë dhe interesin e tyre për disiplinimin pozitiv.
 - **Faza III** (30 minuta): Trajnuesi ndan sipas kategorive të trajnimit pritshmëritë dhe fillon të shpjegojë temat e përcaktuara për trajnim.
 - **Faza IV** (15 minuta): Trajnuesi/ja ndërhyt në ato rubrika ku pjesëmarrësit kanë më shumë nevoja.

Diskutim në grup

Hapat:

1. Pjesëmarrësve u kërkohet të intervistojnë njëri-tjetrin me pyetje prezantuese të llojit:
 - Kush jeni e nga vini?
 - Sa vite keni që punoni në profesionin tuaj?
 - A keni marrë pjesë më parë në trajnime të ngjashme?
 - Çfarë prisni nga ky trajnim?
2. Trajnuesi/ja prezanton veten, qëllimin dhe programin e trajnimit.

Leksion, demonstrim

Trajnuesi prezanton, temën e re duke u bazuar në raste konkrete të shkëputura nga shkolla, po dhe nga shembujt që japin vetë të pranishmit.

Nëpërmjet videove ilustruese tregohen modele konkrete sesi vlerësimi formues, nxit nxënësit të jenë pjesë e procesit mësimor, por edhe zhvillon krijmtarinë e tyre.

a) Përshkrimi i konkretizuar i mjeteve mësimore.

-Materialet e shkruara që mësuesve u sigurohen nga agjencia:

- ✓ fletë pune të modulit,

- ✓ fletë –vetëvlerësimi,
- ✓ prezantimi në powerpoint i trajnuesit, në mënyrë të mësuesit të kenë mundësi të mbajnë shënime,

-Mjetet ndihmëse:

- ✓ Kompjuter dhe Video-projektor, që do të përdoren nga trajnuesi për të realizuar trajnimin.
- ✓ Materiale vizuale (video me raste konkrete rreth vlerësimit, flipcharter për të realizuar dhe prezantuar punët e grupeve, mind/mapping për të njohur mënyrat e organizimit të ideve të reja në mënyrë konceptuale).

b) Detyra për të trajnuarit

Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit dorëzojnë një portofol me këto detyra:

- ☞ Tre modele orësh mësimore në të cilat mësuesi ka përdorur teknikat e reja mësimore për të nxitur vlerësimin formues në klasë, me qëllim uljen e radikalizmit të dhunshëm.
- ☞ Një mind mapping që të përmbajë vështirësitë që pati mësuesi në implementimin e këtyre teknikave por dhe avantazhet e përdorimit të tyre në klasë, për të ndërgjegjësuar nxënësit për tematikën.

c) Literatura e rekomanduar për të trajnuarit për t’u shfrytëzuar gjatë dhe pas modullit.

- ✓ Moduli i përgatitur nga trajneri;
- ✓ Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar, 2013;
- ✓ Udhëzimi i MAS-it për “Ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”;
- ✓ Standardet e shkollës si qendër komunitare, MAS 2014;
- ✓ Udhëzuesi në ndihmë të SHQK, 2014;
- ✓ Raporti Vjetor i Komisionit Evropian 2015 ka njohur përpjekjet e Shqipërisë për të trajtuar radikalizimin dhe terrorizmin dhe i ka bërë thirrje Shqipërisë të "zhvillojë një politikë efektive për të parandaluar radikalizmin, duke përfshirë masat për zbatimin e ligjit dhe veprimeve socio-ekonomike që kanë për qëllim forcimin e përfshirjes sociale, veçanërisht në mesin e të rinjve, si dhe për të rritur përpjekjet për të

identifikuar dhe parandaluar dhe rrjedhën e luftëtarëve të huaj që udhëtojnë në zonat e konfliktit si Irak dhe Siri";

- ✓ Udhëzues tematik i përgatitur nga qendra ALTIR, në bashkëpunim me Terre des Hommes, për uljen e radikalizmit të dhunshëm në shkollë.

10. Testet

Testi 1:

1. Cilët janë faktorët socialë që ndikojnë në radikalizmin e dhunshëm?

2. Cilat janë dokumentet ligjore që i vijnë në ndihmë shkollës, dhe cili është mesazhi kryesor i tyre?

3. Cilat do të ishin metodat dhe teknikat më të mira për të ndaluar shfaqjet e radikalizmit të dhunshëm në shkollë?

Testi 2

1. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar: përmendni tre dokumentet kryesore, dhe përmbledhni shkurtimisht mesazhin e tyre?

2. Cilat do të ishin tre teknikat më të suksesshme që do të përdornit ju si mësues në klasë për të trajtuar temën?

3. Mendoni ju se në qytetin tuaj, janë të rrezikuar fëmijët nga ky fenomen, nëse po jepni arsyet dhe jepni dy zgjidhje që do të përdornit ju për ti ardhur në ndihmë.

Testi 3

1. Cilat janë 3 detyrat kryesore të secilit institucion arsimor për të luftuar ndaj radikalizmit të dhunshëm?
2. Çfarë do të bënit ju si mësues në shkollë për të rritur bashkëpunimin me komunitetin dhe prindërit për ti ndërgjegjësuar rreth fenomenit?
3. Cilat ishin disa nga mesazhet kryesore që ju morët nga ky trajnim?

11. Bibliografia kryesore e përdorur për të hartuar modulin.

Vendosni një numër të kufizuar botimesh (libra, shkrime ose nga interneti)